SI FUNKSIONON NJOHJA E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE JASHTË BASHKIMIT EUROPIAN?

Ju dëshironi të punoni në Gjermani në profesionin tuaj? Në disa raste është e nevojshme njohja e kualifikimit tuaj profesional dhe në disa raste jo. Por edhe njohja vullnetare e kualifikimit gjithashtu ka shumë përparësi. Vini re hapat dhe informacionet në vijim:

GOETHE INSTITUT

A E DI UNË PROFESIONIN TIM REFERUES?

JO → SI TA GJEJ PROFESIONIN REFERUES

PO → A ËSHTË PROFESIONI IM REFERUES
A. I RREGULLUAR
B. I PARREGULLUAR?

SI TA GJEJ PROFESIONIN REFERUES

Njohja e kualifikimit në Gjermani • Vetë-testimi dhe këshilla (gjithashtu me telefon / personalisht) në www.anerkennung-in-deutschland.de

Berufenet (Agjencia për punësim) • Shërbimi i informacionit në www.berufenet.arbeitsagentur.de

Make it in Germany • Këshillime online ose telefonike në www.make-it-in-germany.com

Dhoma e Industrisë dhe Tregtisë, Foreign Skills Approval (IHK FOSA) • Këshilla personale, termine në www.ihk.de

LISTA POZITIVE

Kontrolloni këtë listë të profesioneve, për të cilat momentalisht janë duke u kërkuar urgjentisht punëtorë të kualifikuar, në adresën www.arbeitsagentur.de/positivliste. Nëse profesioni juaj referues është në këtë listë, ju keni shanse shumë të mira në tregun gjerman të punës. Por ju duhet të aplikoni për njohjen e profesionit tuaj. Nëse keni një diplomë universiteti të njohur në Gjermani, mund të krijohen më shumë mundësi për ju.

A → PROCEDURA E NJOHJES PËRMES IHK FOSA, DHOMAVE TË INDUSTRISË DHE TREGTISË (IHK) DHE DHOMAVE TË ZEJTARËVE (HWK)

Procedura e njohjes është gjithmonë individuale dhe ndonjëherë e komplikuar. Kjo gjithashtu do të thotë se për raste të ndryshme ekzistojnë ligje të ndryshme dhe persona kontaktues të ndryshëm. Gjithashtu kjo varet edhe nga Landi në të cilin dëshironi të punoni dhe të jetoni. Varësisht se sa kompleks është rasti, procedura zgjat deri në tre muaj dhe kushton 100-600 €.

DOKUMENTET DUHET TË PËRKTHEHEN DHE TË VËRTETOHEN

Një listë të dokumenteve të nevojshme, si p.sh. dëshmia e identitetit, dëshmia e kualifikimit tuaj profesional dhe përvojës tuaj profesionale, mund ta gjeni te Anerkennungs-Finder në www.anerkennung-in-deutschland.de. Ju mund të informoheni në IHK se cilat dokumente ju nevojiten.

Një listë të përkthyesve shtetëror të licencuar e gjeni në www.justiz-dolmetscher.de si dhe pranë Agjencisë Federale të Punësimit.

APLIKIMI PËR VLERËSIMIN E BARASVLERËS

ANALIZA E KUALIFIKIMIT

p. sh. në formën e punës provuese ose bisedës profesionale. Kjo bëhet nëse dokumentet nuk janë të plota dhe kjo ka ndodhur pa fajin tuaj.

PROCEDURA VULLNETARE E NJOHJES SË KUALIFIKIMIT

Ofron shanse më të mira në tregun gjerman të punës, mundësinë për arsimim të mëtejshëm dhe madje edhe një pagesë ndoshta më të mirë.

B

POZITIVE

Barasvlera e plotë:
Njohuritë dhe aftësitë tuaja të huaja korrespondojnë me kualifikimin profesional gjerman. Për këtë shih gjithashtu nenin 18 të Ligjit për qëndrim.

PJESËRISHT POZITIVE

Barasvlera e pjesshme:
Kualifikimi juaj profesional i huaj korrespondon me kualifikimin profesional gjerman në disa pika, por jo në aspekte të tjera.

Qasja në tregun e punës sipas nenit 17a të Ligjit për qëndrim është e mundshme për një vit në qoftë se puna ndërlidhet ngushtë me profesionin që duhet të njihet dhe në qoftë se përmes punës mund të sigurohet jetesa. Më pas është e nevojshme një procedurë e re e njohjes.

NEGATIVE

Asnjë barasvlerë: Kualifikimi juaj i huaj nuk mund të krahasohet me kualifikimin gjerman. Aplikimi juaj është refuzuar.

Informacione për atë se çfarë mund të bëni në këtë rast gjeni në Netzwerk IQ (www.netzwerk-iq.de).

JU MUND TË APLIKONI PËR PUNË!

Tani mund të kërkoni një vend të lirë pune në Gjermani, mund të aplikoni për punë dhe të filloni të punoni pas marrjes së lejes përkatëse të qëndrimit. Informacione lidhur me këtë mund të gjeni, për shembull, në Agjencinë Federale të Punësimit. Ju lutem vini re se për disa profesione duhet së pari të kryeni një test të njohurive profesionale dhe të gjuhës profesionale.

NJOHURITË E GJERMANISHTES

Njohuritë e mira të gjuhës gjermane ju ndihmojnë gjatë startit në jetën profesionale. Njohuritë e nivelit B1 janë shpesh parakusht për këtë. Kurse të gjuhës gjermane në vendin tuaj mund të gjeni në www.goethe.de

APLIKIMI PËR NJË VIZË NË AMBASADËN GJERMANE

Pas aplikimit me sukses për një vend pune, tani mund të aplikoni për vizë. Këtë mund ta bëni në përfaqësinë përkatëse të Gjermanisë.

Ministria Federale e Punëve të Jashtme • Informacione dhe termine në www.auswaertiges-amt.de

APLIKIMI PËR LEJE QËNDRIMI ME LEJE PUNE NË ZYRËN PËR TË HUAJT (PAS ARRITJES NË GJERMANI)

Qendrat Virtuale për Mirëseardhje (Welcome Centers) pranë ZAV • Konsultimet online, kontaktoni www.make-it-in-germany.com

Quick-Check • Test i shpejtë nëse ju mund të jetoni dhe punoni në Gjermani në www.make-it-in-germany.com

Zyra për të huajt • Zyra më e afërt për konsultim në qytetin tuaj në "Mein Weg nach Deutschland" www.goethe.de/mwnd

Europa fördert
Asyl-, Migrations-, Integrationsfonds

Ky projekt bashkëfinancohet nga Fondi për Azil, Migracion dhe Integrim